



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.999/22

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTSHP “M...” me seli në Shtime, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1242/18 të datës 15.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.03.2023, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**Aprovohet** si e bazuar ankesa e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, e datës 07.05.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.1242/18 të datës 15.03.2021, **prishet** dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal ka vendosur: nën pikën I. të dispozitivit, është aprovuar kërkesëpadia e paditësit NTSHP “M...” me seli në Shtime. Në pikën II. Anullohet Vendimi nr.303/2006 i dates 08.08.2006 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Në pikën III. Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës që paditësin NTSHP “M...” me seli në Shtime, ta liroj nga ngarkesa dhe pagesa për të gjitha llojet e tatimit shtesë të rezultuar nga rritja e qarkullimit shtesë në vlerë prej 18,022.63€ për periudhën tatimore 12/2003. Në pikën IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura ka ushtruar ankesë me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë të aprovoj ankesën e ATK-së si të bazuar dhe aktgjykimi i atakuar të anulohet apo çështja të kthehet në Gjykatën e Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të ankimuar, si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me Vendimin nr.303/2006 të datës 08.08.2006, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Refuzohet si e pa bazuar ankesa e tatimpaguesit NTSHP "M..." me NRB ..., pronar M.R rr. "... " pa nr. Shtime, si e pa bazë kundër vendimit mbi Njofim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të Administratës Tatimore-Regjioni i Ferizajit. N pikën II. Procedura e ankesës nuk ndërprejnë sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit nr.2004/48 Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, paditësi, ushtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në procedurë të konfliktit administrativ. Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të datës 15.03.2021, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, të mbajtur në mungesë të palëve ndërgjyqëse dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar: Me Raport të Kontrollit paditësi është ngarkuar me tatim shtesë në shumë të përgjithshme prej 4,511.53€ me ndëshkime, në emër të tatimit të paragjykuar, Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, Tatimit në Fitim dhe në emër të Kontributeve Pensionale për punëdhënës. Deri te qarkullimi dhe tatimi shtesë me kontroll ka ardhur nga analiza financiare e zhvilluar me kontroll, ku si rezultat i kësaj është konstatuar mungesa e stokut në vlerë prej 54,520.89€, dhe nga kjo vlerë kontrolli ka zbritur vlerën

prej 38,000.00€ në emër të mallit të djegur si pasojë e djegjes së lokalit të paditësit, ndërsa ka konstatuar mungesë financiare të mallit në vlerë prej 16,520.89€ e cila vlerë më pastaj me kontroll është kalkuluar si qarkullim shtesë i pa deklaruar nga tatimpaguesi/paditësi me marzhën e supozuar prej 9,09% ku është fituar vlera prej 18,022.63€. Gjykata konstaton se lidhur me këtë çështje juridike administrative, fillimisht ish Bordi i Pavarur për Rishqyrtime dhe Aktvendimin A.nr. 582/2006 të datës 30.11.2006, kishte aprovuar ankesën e paditësit, kishte anuluar vendimin e ATK-së me nr. 303/2006 të datës 08.08.2006, lidhur me tatimin shtesë në kategorinë e tatimit të paragjykuar dhe TVSH-së sipas Njoftim Rivlerësimeve, Mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin A.nr. 323/2007 të datës 14.04.2009 kishte aprovuar padinë e ATK-së të ushtruar ndaj Aktvendimit të BPR-së A.nr. 582/2006 të datës 30.11.2006, kishte anuluar këtë vendim dhe lëndën e kishte kthyer në riprocedurë tek ish Bordi i Pavarur për Rishqyrtime, si organ në rivendosje duke vepruar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me aktvendim A.nr.582/2006 të datës 01.09.2014, ka aprovuar ankesën e subjektit NTSHP “M...” me seli në Shtime, duke anuluar vendimin e ATK-së me nr.303/2006 të datës 08.08.2006 dhe ka liruar paditësin nga ngarkesa dhe pagesa e të gjitha llojeve të tatimit shtesë të rezultuar nga rritja e qarkullimit shtesë në vlerë prej 18,022.63€, për periudhën tatimore 12/2003. Gjykata konstaton se e paditura as në vendimin e kontestuar, por as në Raportin e Kontrollit fare nuk e ka trajtuar si provë deklaratën e parë të dhënë nga probari i biznesit M.R të datës 15.03.2006 ku i njejtë kishte deklaruar *“se me datën 23.12.2003 i është shkaktuar dëm i madh material me rastin e djegjes së lokaleve afariste në Shtime sipas procesverbalit të Policisë me nr. të lëndës AU1237 të datës 23.12.2003 dhe diferenca e lajmëruar në mes të shitjeve të deklaruar, stokeve dheblerjeve është pasojë e rastit të cekur më lartë”*. Në këtë aspekt gjykata konstaton se të paditurës i ka mjaftuar arsyetimi se kontrolli është bazuar në deklaratën e tatimpaguesit të datës 22.03.2006 ku tatimpaguesi kishte deklaruar se si vlerë të mallit të tij të djegur në lokal kishte qenë vlera rreth 30,000.00€-40,000.00€, mirëpo për gjykatën kjo nuk është e pranueshme, sepse e paditura nuk ka dhënë fare sqarim se pse deklarata e datës 22.03.2006 është më e besueshme, ndërsa deklarata e datës 15.03.2006 jo. Prandaj, gjykata duke vepruar sipas rekomandimeve dhe vërejtjeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, bazuar në aktgjykimin AA.nr. 397/2014 të datës 16.05.2018 në rivendosje ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit nr. 303/2006 të datës 08.08.2006 të Administratës Tatimore të Kosovës, ka eliminuar të metat e konstatuar me aktgjykim dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njetat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”*, dhe nenet 183 dhe 184 të LPK-së, sepse arsyet në të cilat bazohet për faktet vendimtare janë të pa qëndrueshme dhe jo të plota, nuk janë shqyrtuar në tërësi faktet sipas bazave ligjore të dispozitave materiale, andaj si pasojë e kësaj edhe gjendja faktike e çështjes është vërtetuar gabimisht. Andaj pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë nuk mund t'i përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme për shkak se, arsyet në të cilat bazohen për faktet vendimtare lidhur me mënyrën e vendosjes, janë jo të qëndrueshme dhe në kundërshtim me faktet të cilat i thekson paditësi në ankesë, sepse është fakt i pa mohueshëm se gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke e zbatuar gjendjen faktike në mënyrë të gabuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë, pretendimet e palës ankuese i mori si të drejta dhe të ligjshme pasi që, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, thënieve të gjykatës së shkallës së parë, pretendimeve ankimore të palës paditëse, gjeti se vendimi i Gjykatës së shkallës së parë është i pa drejtë. Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike, pasi që nuk është vërtetuar me analizë materiale dhe financiare mungesa e stokut të mallit për paditësin, ku me këtë rast e paditura vendimin e vet e ka bazuar në nenin 17.2 të Ligjit nr. 2004/48, pasi që sipas Raportit të Kontrollit dhe Njoftim Rivlerësimit e kontrollit, duke konstatuar se kontrolli është bazuar në parregullësitë dhe regjistrimet e tatimpaguesit nga të cilat nuk ka mundur të vërehet saktë se cila vlerë është dëshmuar si mall i dëmtuar nga djegja e lokaleve të paditësit. Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se paditësi as para gjykatës as në procedurë administrative tek e paditura nuk ka prezantuar prova, mirëpo vetëm deklarata në të cilat nuk ka theksuar saktë vlerën e mallit të dëmtuar, mirëpo vetëm ka theksuar se paditësit

i është shkaktuar dëm i madh material, pa prezantuar prova materiale se sa është dëmi i pretenduar nga paditësi.

Prandaj, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur si në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta për të cilat nuk mund të lejohen, dhe se është juridikisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë, në seancë gjyqësore, duhet të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit kontestues, vendim i marrë nga e paditura, e që është objekt shqyrtimi në këtë çështje juridike, të vlerësojë edhe një herë kërkesë padinë e paditësit dhe të vërtetoj në mënyrë të plotë gjendjen faktike lidhur me qarkullimin dhe tatimin shtesë për paditësin e sipas nevojës të siguroj edhe prova shtesë, dhe nëse nga rrethanat e çështjes vlerëson se akti kontestues duhet anuluar atëherë të vendos në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditësit duke marrë aktgjykim të drejtë me dispozitiv dhe arsyetim të qartë dhe të bazuar në dispozita ligjore, i cili do të zëvendësonte aktin e anuluar.

Për arsyet e lartë cekura, aktgjykimi i kundërshtuar është dashtë të prishet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për t'i mënjanuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të theksuara më lartë, e që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur. Në ri-procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet ti mënjanoj të metat e vërejtura sipas këtij aktgjykimi, dhe pas mënjanimit të tyre, ka mundësi të bie aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

K.DH.SH.II.nr.999/22, me datë 30.03.2023

**Kryetare e kolegjit,  
Saranda Bogaj Sheremeti**